



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: Gjuhë angleze

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik (Financa)
Titulli i lëndës:	Gjuhë angleze
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i parë (I), semestri I
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Ligjërata: Mërkur – 11:30 – 13:00; B02 Ushtrime: Hënë – 09:45 – 10:30; B03 Asistent: Teuta Agaj
Mësimdhënësi i lëndës:	Ali Xhelili
Detajet kontaktuese:	045 355 266; alixhelili@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda Gjuha angleze profesionale është kurs i gjuhës së huaj për qëllime specifike, i cili fokusohet në prezantimin dhe shtjellimin e terminologjisë profesionale për studentët e drejtimit të Financave. Kursi është i ndarë në ligjërata dyorëshe, respektivisht në ushtrime njëorëshe gjatë të cilave studentët do të njihen me fjalorin e marketingut në gjuhën angleze dhe të njëjtin do ta përdorin gjatë ushtrimeve në klasë. Për më tepër, kursi është i dizajnuar në atë mënyrë që studentët diskutojnë dhe debatojnë rreth fushave të tyre profesionale. Kjo çasje u mundëson atyre të përforcojnë dijet e tyre rreth fushës së ngushtë profesionale dhe, në të njëjtën kohë, të mësojnë dhe të përdorin gjuhën e huaj për të lehtësuar komunikimin e tyre me anglishtfolës të tjerë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Përpos zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të fituara gjatë shkollimit paraprak, mësimi, përvetësimi dhe përdorimi i terminologjisë në kontekste profesionale në gjuhën angleze është qëllimi parësor i këtij kursi. Shkëmbimi i ideve, informatave dhe përvojave në rrafshin profesional nëpërmjet gjuhës së huaj është në fokus të këtij kursi semestral. Njëherish, studentët aftësohen të avancojnë njohuritë e tyre rreth dhe për gjuhën angleze.</p>

Rezultatet e pritura të nxënies:	Në fund të këtij kursi, pritjet janë që studentët të jenë në gjendje të: përvetësojnë dhe përdorin terminologjinë profesionale në gjuhën angleze në kontekstin profesional; të dallojnë nuancat e ndryshme kuptimore të fjalëve dhe termeve në gjuhën angleze; të shprehen qartë dhe rrjedhshëm në gjuhën e huaj; komunikojnë lirshëm dhe pa pengesa të mëdha në gjuhën angleze; si dhe lexojnë, hulumtojnë dhe studiojnë materiale dhe literaturë profesionale në gjuhën angleze.
---	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Kollokfiime,seminare	1	5	5
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	1	4	4
Totali			100

Metodologjia e mësimdhënies:	Avancimi i shkathtësive të gjuhës së huaj (komunikimi i lirë dhe i natyrshëm në të folur edhe në të shkruar) synohet të arrihet përmes përdorimit të një laryshie motodash të mësimdhënies/ nxënies. Kursi do të realizohet përmes metodave të kombinuara, varësisht nga natyra e ligjëratës, duke përfshirë: ligjërata të rregullta, ushtrime praktike, diskutime në grup, prezantime të temave relevante për kursin, punë ekipore për analizimin dhe zhvillimin e hulumtimeve të vogla lidhur me temat e studimit, konsultime gjatë gjithë semestrit. Kryesisht do të dominojë metoda e mësimi ndërveprues si dhe do të aplikohen variante të ndryshme shpjegimi si: sqarimet, analizat, ushtrime, prezantime, pyetje, detyra etj. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi i mësimdhënësit dhe studentëve gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është çelësi i suksesit.
-------------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<p>Testi i parë: 20 pikë Testi i dytë: 20 pikë Detyrat e shtëpisë: 10 pikë Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Provimi përfundimtar: 40 pikë Totali: 100 pikë.</p> <p>Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	MacKenzie, Ian. <i>Professional English in Use: Finance</i> . Cambridge University Press, Cambridge, 2006.
Literatura shtesë:	Evans, David. <i>Business English Verbs</i> . Pearson Education Limited, UK, 2000. Ellman, Patricia. <i>English Grammar for Economics and Business - For students & professors with English as a Foreign Language</i> . bookboon.com; 2014.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njoftimi me lëndën – Money and Income
<i>Java e dytë:</i>	Business finance Accounting and accountancy
<i>Java e tretë:</i>	Bookkeeping Company Law 1 & 2
<i>Java e katërt:</i>	Accounting policies and standards Accounting assumptions and principles
<i>Java e pestë:</i>	Depreciation and amortization Auditing
<i>Java e gjashtë:</i>	The balance sheet (assets) The balance sheet (liabilities)
<i>Java e shtatë:</i>	The other financial statements Financial ratios 1
<i>Java e tetë:</i>	Financial ratios 2 First written test
<i>Java e nëntë:</i>	Cost accounting Pricing
<i>Java e dhjetë:</i>	Personal banking Commercial and retail banking
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Financial institutions Investment banking

<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Central banking Interest rates
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Money markets Islamic banking
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Money supply and control Venture capital
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Stocks and shares Second written test

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Gjatë ligjëratave, ushtrimeve, testeve dhe provimit studentët dhe ligjëruesi janë të obliguar që të u përmbahen parimeve profesionale, etike dhe akademike të Universitetit “Kadri Zeka”. Mospërfillja e këtyre normave, të cilat burojnë nga Statuti i universitetit “Kadri Zeka” do të ndëshkohet sipas rregullave të parapara!